

Relacionin Shpjegues Per Aktivitetin

Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj; b. shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne cisternat e stacioneve te furnizimit me karburant.



Person Juridik: "A.N.K." Sh.p.k

Nr. NIPT: J92408001N

Vendndodhja: Kamez, Tirane.

Subjekti: "A.N.K." Sh.p.k



Tirane, 2025

Permbledhje

1. Hyrje.....	3
2. Pershkrim i aktivitetit	3
3. Perfundime.....	5

1. Hyrje

Subjekti “A.N.K” sh.p.k me administrator **Z. Agim Kola**, eshte regjistruar prane QKB me NIPT **J92408001N**, aktiviteti i te cilit eshte i perqendruar ndertimin e rugeve, autostradave, mbikalimeve, hekurudhave, tramvajeve dhe metrove. Kompania gjithashtu kryen punime ne ujesjelles, gazsjelles, vepra kullimi dhe vaditje, si dhe punime per mbrojtjen lumore dhe sistemime hidraulike. Pervec kesaj, kompania kryen rikonstruksione, projektme te ndryshme, tregtim makinash dhe pajisjesh industriale, si dhe materialeve te ndertimit. Aktivitetet e tjera perfshijne shpime nen tokesore per marrjen e ujit, prodhimin e asfaltit dhe betoni, transportin e mbetjeve inerte dhe trajtimin e ujerave te zeza urbane.

Aktualisht operatori disponon Leje Mjedisore Tipi B me PN-5846-07-2013, me Nr. 303/9 Prot., Date 16.07.2013, per aktivitetin “*Impiante dhe magazinim te mjeteve te renda te ndertimit*”.

Ne vijim te ketij angazhimi, operatori kerkon te rishikoje lejen mjedisore ekzistuese me qellim perfshirjen e aktivitetit: “*Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj: b. Shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne cisternat e stacioneve te furnizimit me karburant.*” Ky aktivitet, se bashku me te gjitha specifikimet teknike dhe mjedisore perkatese, do te trajtohet ne kapitujt vijues te ketij relacioni, ne funksion te plotesimit te dokumentacionit per rishikimin e lejes mjedisore. Operatori eshte i pajisur me te gjitha masat teknike dhe infrastrukture te nevojshme per garantimin e sigurise se objektit ne perputhje me standardet dhe kerkesat ligjore ne fuqi. Ne vecanti, jane vendosur sisteme te posaçme per mbrojtjen e objektit nga rreziku i renies ne tension te instalimeve si pasoje e shkarkimeve atmosferike.

Gjithashtu, operatori ka zbatuar masa te plota per mbrojtjen nga zjarri, duke perfshire instalimin e sistemeve te zbulimit dhe sinjalizimit te hershem te zjarrit, pajisjeve per fikjen e zjarrit, si dhe sigurimin e infrastruktures ndihmese per nderhyrje emergjente ne perputhje me kerkesat teknike per objektet me risk te tille.

Per me teper, subjekti eshte i pajisur me Certifikaten e Mbrojtjes nga Zjarri, e leshuar nga eksperti, e cila verteton permbushjen e te gjitha kushteve te sigurise ne rast zjarri dhe perben nje garanci shtese per mbrojtjen e jetes njerezore, pasurive materiale dhe mjedisit perreth.

2. Pershkrim i aktivitetit

Pershkrim rreth projektit teknologjik nafte

Projekti teknologjik “Impiant i furnizimit me Nafte” ka parashikuar furnizimin me nafte per perdorim vetjak (furnizimin e mjeteve te punes) te subjektit ANK Shpk i cili ndodhet ne rrugen Kosova Kamez.

Kapaciteti depozitues eshte 188m³ litra karburant (Nafte) ne 3 depozita mbitoke.

Teknologjia

1. Kapaciteti dhe regjimi i punes

Llogaritjet teknologjike perkatese te prodhimitarise per kete object te furnizimit vetjak per mjetet e punes qe disponon, qe ndodhet ne Kamez, jane bere mbi bazen e kapaciteteve depozitues te rezervuareve. Furnizohet me karburant me automjete te tipit cisterne nga njesite e depozitimit e tregetit me shumice.

Mbushja e rezervuareve do te behet pa nderprerje te procesit te shitjes. Remontet eventuale dhe te vazhdueshme te pikes se shitjes dhe ato ne raste avarish mund te behet ne vazhdim.

2. Zgjedhja e skemes teknologjike.

Zgjedhja teknologjike eshte e thjeshte, elastike dhe mjaft funksionale. Mbi bazen e skemes teknologjike te zgjedhur eshte percaktuar dhe skema e lidhjes se aparaturave. Duke patur parasysh normat ne projektim volumi i dobishem i rezervuareve eshte 6% me i vogel nga ai gjeometrik i tyre.

Lidhja teknologjike realizohet me tre linja:

- linja e ngarkimit te rezervuareve
- linja e thithjes se shperndarjes se naftes
- linja e ajrimit te rezervuareve

Tubat e perdorur ne linjat teknologjike te tubacioneve jane prej celiku te zinkuar, konform kerkesave teknike te projektimit per linja te tilla.

3. Zgjedhja e makinerive dhe e pajisjeve kryesore

Makinerite dhe pajisjet kryesore te pikes se shitjes, jane zgjedhur duke u bazuar ne te dhenat fillestare te produkteve, qe trajtohen dhe kapacitetit perpunues te saj.

Rezervuaret e vendosur ne kete objekt, mbeshtetur ne skemen teknologjike te zgjedhur si dhe ne kerkesat e tregut, sigurojne nje kapaciteti maksimal te pikes prej rreth 10 ditesh.

Distributori i vendosur ne skeme eshte zgjedhur ne perputhje me kapacitetin e kerkuar te pikes dhe standarteve te prodhimit boterore. Karakteristikat kryesore teknike dhe metrologjike jane:

- Prurja, 50litra/min
- Temperatura e funksionimit, -20 deri ne +40°C
- Presioni maksimal 300000Pa
- Vakumi i thithjes 40000Pa
- Tensioni i rrymes se ushqimit te kohes matese, 220V
- Peshja ne gjendje te ambalazhuar, 350kg
- Treguesit e motorit trefazor me rregjim te panderprere

- Fuqia 3x1 kw
- Tensioni i rrymes se ushqimit 220/380 V
- Frekuenca 50hz

Skema teknologjike e furnizimit te rezervuareve te produkteve te naftes, eshte zgjedhur e tille qe siguron furnizimin e tyre me cikel te hapur dhe te mbyllur. Menyra e furnizimit me cikel te mbyllur ka epersine se eviton daljen e avujve te produktit te naftes qe furnizohet ne mejdis, megjithate ajo mbetet e varur nga tipi i autocisternes qe perdoret.

Pjesa e pergjithshme dhe transporti

a) Vendndodhja e sheshit te ndertimit

Per ndertimin e ketij objekti, sic eshte permendur dhe me lart, si shesh do te perdoret trualli i ndodhur ne Kamez ne Rrugen Kosova. Pozicioni i kesaj pike eshte i favorshem dhe mundeson manovrimet funksionale te mjeteve, qe kane nevojte per furnizimi me karburant.

b) Plan i pergjithshem dhe kompozim i objektit

Kompozimi i objektit eshte realizuar ne baze te skemes se lidhjes teknologjike te aparaturave si dhe te mundesive te dhena nga sheshi ne dispozicion per ngritjen e tij. Ne kerkesat kurdohere te parashtruara para projektuesve ka qene dhe shfrytezimi maksimal i siperfaqes se truallit ne dispozicion. Kjo eshte arritur fale kompozimit te vendosjes se pajisjeve dhe te aparaturave te nevojshme.

c) Transporti i brendshem

Levizja sa me elehte dhe e thjeshte e automjeteve, qe furnizohen me karburant si dhe te automjeteve special ne raste emergjente, sin je detyre e projektit, eshte realizuar permes zgjidhjes optimale te rrugeve brenda objektit dhe vendosjes se distributoreve.

Furizimi dhe shperndarja e energjise elektrike

Furizimi me energji elektrike, per nevojat e fuqise motorike dhe te ndricimit, behet perms linejs elektrike qe vjen nga kabinat elektrike 20/0,4kv e ndodhur ne afersi te truallit. Per ti paraprire nderprerjes se furnizimit me energji elektrike nga rrjeti i sistemit unik, eshte parashikuar vendosja e grupit moto gjenerator, i cili do te siguroje vazhdueshmerine e punes ne objekt.

3. Perfundime

Ne kete raport eshte paraqitur nje shpjegim i detajuar i proceseve teknologjike qe lidhen me aktivitetin per te cilin subjekti "A.N.K" sh.p.k kerkon te kryeje ndryshim ne lejen mjedisore

ekzistuese. Ky aktivitet i propozuar eshte ne perputhje me zhvillimet aktuale te veprimtarise se operatorit dhe kerkon perfshirjen zyrtare ne kuader te kushteve te lejes se meparshme.

Aktualisht, operatori eshte ne pritje te komunikimit zyrtar nga autoritetet pergjegjese per te nisur proceduren formale te rishikimit te kushteve te lejes mjedisore ekzistuese. Ky rishikim synon te perditesoje dhe plotesoje dokumentacionin ligjor dhe teknik te subjektit, ne menyre qe te reflektoje ne menyre te sakte dhe te pergjegjshme zhvillimet e reja ne aktivitetin qe ai ushtron.